



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 24
Prishtinë, më 24 korrik 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Valon Ramadani, Avdullah Hoti, Verica Qeraniq, Andin Hoti dhe Ali Lajçi.

Munguan: Ahmet Isufi, Zafir Berisha, Albert Kinolli dhe Faton Topalli.

Stafi mbështetës: Mehmet Simnica, Ajet Avdullahu dhe Endrit Rustemi.

Pjesëmarrësit tjerë: Amir Gashi, Ilir Avdullahu, Sokol Duraku, Ariton Gërxhaliu dhe Salih Gjonbalaj, nga KRU Prishtina. Drita Vitia - Radio Kosova, Emine Shehu, praktikante Kuvendi/Zyra për Informim, Mehmet Krasniqi, Ekonomia Online, Vlora Spanca, Enver Begolli dhe Bahri Statovci-ZKA.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura më 10.7.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për KRU Prishtina Sh.A, për vitin 2017;**
- 4. Diskutimi në lidhje me shqyrtimin e Raporteve të Auditimit të Komunave, për vitin 2017;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.7.2018

Përfundimi

Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 10.7.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për KRU Prishtina Sh.A për vitin 2017

Kryetari njoftoi se sot është në shqyrtim raporti auditimit i Kompanisë Regjionale të Ujit “ Prishtina”, ndërsa raportin do ta paraqesë deputeti Ali Lajçi.

Ali Lajçi, njoftoi deputetët se raporti i auditorit ka paraqitur probleme në procesin e menaxhimit, si në shpenzime të prokurimit, ndryshim të projekteve dhe mosrealizim të tyre sipas dinamikës, menaxhim të personelit, në shtim të punëve të cilat nuk parashihen shpeshherë etj.

Lajçi tha se kemi edhe rekomandimet të cilat dalin edhe si obliguese. Në përgjithësi mund të themi se rekomandimet në zbatueshmëri çalojnë, dhe jo vetëm të kësaj kompanie, por në shumicën e kompanive. Por, kur shohim se cilat janë defektet, vërejmë se kemi probleme shpesh në paraqitjen e saktësisë të pasqyrave financiare. Ai shtoi se rekomandimet duhet të zbatohen, sepse kjo ndikon edhe në menaxhimin më të mirë dhe më cilësor.

Amir Gashi, foli për ecurinë e performancës së KRU”Prishtina”. KRU “Prishtina” në tri vitet e fundit ka pasur ngritje të të hyrave, por këto tri vite kanë qenë kryesore për ngritjen e kualitetit të shërbimeve me ujë. Sot në KRU “Prishtina” ka kapacitete të mjaftueshme për furnizim me ujë 24 orë. Humbjet në rrjet janë një shqetësim yni, por që kjo është pasojë e furnizimit 24 orë. Shqetësim për ne janë edhe humbjet komerciale, të cilat bashkëpunim me inspektorët komunalë, në vazhdimësi po mundohemi që ti ulim, por kjo në masë të madhe është vështirë për tu realizuar. Sa i përket raportit ne e falënderojmë Zyrën e Auditorit për raportin. Bordi këtë të enjte do të mblidhet që të bëjë planin e veprimit, në afatet e parapara.

Kryetari, e hapi debatin por edhe parashtroi pyetje lidhur me diferencat financiare. Kjo diferencë kapë shifrën prej 316.999€. Pse kjo diferencë? Pyetja e dytë është me rezervuarët e naftës. Raporti ka gjetur se nga krahasimi i gjendjes fizike të rezervuarëve kemi diferencë prej 33,436 litra naftë, apo rreth 25,057€ më pak.

Ali Lajçi, pyeti në lidhje me pasuritë e paluajtshme dhe mosregjistrimin joadekuat të tyre?

Ilir Abdullahu, tha se duke u nisur nga pyetja e fundit e deputetit Lajçi, vlerësimi i aseteve ende nuk është bërë. Por, besoj se në planin e veprimit do të caktohet që vlerësimi i aseteve të kryhet sipas standardeve.

Rreth derivateve të naftës, ne kemi formuar një komision për këtë çështje. Ka pasur probleme në saktësinë e pompës. Ne kemi ndërmarrë masa deri në suspendimin e zyrtarit që është përgjegjës për këtë çështje si dhe ju kemi drejtuar edhe drejtësisë, e cila është duke u marrë me këtë çështje.

Ndërsa, në lidhje me diferencën financiare, Abdullahu tha se ato janë rezultati i mbingarkimit dhe që beson që në të ardhëm këto diferenca nuk do të përsëriten.

Kryetari, bëri pyetje lidhur me menaxherët të cilëve ju kishte skaduar kontrata në vitin 2016? Gjithë vitin 2017 ata janë paguar pa kontrata. Kontratat e tyre janë nënshkruar tek me 1 janar të vitit 2018, pse është lejuar kjo situatë?

Iir Abdullahu, tha se kontratat e menaxherëve janë vazhduar me një vendim të tij, mirëpo që vendimi i tij nuk kishte shkuar në administratë.

Avdullah Hoti, pyeti për humbjet e ujit në rrjet dhe si po reflektohet kjo në tarifat e ujit që kanë konsumatorët. Humbjet në rrjet janë diku rreth 57%, si e llogaritni ju koston e kësaj, sepse po i bie që konsumatorët të paguajnë për ujin që realisht nuk e shfrytëzojnë. Po ashtu, Hoti pyeti edhe për reagimet e qytetarëve në Fushë- Kosovë, për shkak të mungesës së ujit?

Iir Abdullahu, tha se humbjet e ujit shkojnë deri në 57% dhe kjo është pasojë e mbulueshmërisë së furnizimit me ujë 24 orë. Ai përmendi edhe humbjet e ujit në vendet në rajon dhe po ashtu, tha që detyra jonë është t'i zvogëlojmë këto humbje.

Avdullah Hoti, pyeti pse janë rritur humbjet nga 53% në 57%, ndërkohë në pjesën më të madhe të Prishtinës janë zëvendësuar gypat?

Iir Abdullahu, theksoi se së bashku me rregullatorin kemi përfunduar tarifat për vitet e ardhshme dhe kostoja është 43 cent dhe 5 cent është për ujëra të zeza. Rritja e humbjeve është si pasojë e rritjes së furnizimit me ujë. A tha që një pjesë e humbjeve është fizike, ndërsa pjesa tjetër është humbje komerciale.

Avdullah Hoti, pyeti se sa është inkasimi i asaj që faturohet?

Iir Abdullahu, tha se inkasimi në gjashtë muajt e fundit është 97%.

Avdullah Hoti, tha se kjo i bie që qytetarët janë duke paguar dyfish më shumë sesa shpenzojnë.

Mërgim Lushtaku, pyeti a është bërë ndonjë strategji për ti zvogëluar këto humbje si dhe për problemin e furnizimit me ujë të Komunës së Fushë- Kosovës?

Iir Abdullahu, tha që kostoja e furnizimit me ujë e Fushë- Kosovës është rreth 460 mijë euro. Ne si kompani kemi përfunduar rreth 2.2 km tubacion. Për çështjen e strategjisë, ai tha që kemi aprovuar një strategji për reduktimin e humbjeve të ujit.

Kryetari, tha që çështja e këtij raporti duhet të diskutohet edhe në seancë plenare dhe më pas të nxirren edhe rekomandime konkrete se çka duhet të bëjmë që këto probleme të mos na përsëriten, me çka u pajtua edhe Avdullah Hoti, kurse me këtë pajtua edhe Valon Ramadani.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që Raportit të Auditimit për KRU Prishtina Sh.A për vitin 2017 të adresohet për në seancë plenare, së bashku me rekomandimet e Komisionit Funkcional .

4. Diskutimi në lidhje me shqyrtimin e Raporteve të Auditimit të Komunave për vitin 2017

Kryetari, njoftoi deputetët se më 25.7.2018, do të mbahet një dëgjim publik në “Villa Gërmia” prej orës 10:00, në organizim të KMFP-së dhe i përkrahur nga GIZ-i. Ai ftoi deputetët që të marrin pjesë.

5. Të ndryshme.

KMFP, vendosi që më 25.7.2018 të mbajë dëgjimin publik për të diskutuar raportet e auditimit për komunat.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Driton Selmanaj